

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA THEMELORE STRUGË
SU-04.nr.52/22
03.11.2022
Strugë



Në bazë të nenit 20 paragrafi 1, alineja 2, nenit 39 dhe neni 40 nga Ligji për Nëpunësit Gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 43/14, 98/15, 33/15, 06/16, 198/18 dhe 248/18) dhe Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes interne, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancim, mënyra e zbatimit të selektimit administrativ dhe intervistës, si dhe mënyra e vlerësimit të tyre-pikëve dhe numri maksimal i pikëve nga procedura e selektimit në varshmëri nga kategoritja e vendit të punës për të cilin është publikuar shpallja interne ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 275/20), GJYKATA THEMELORE STRUGË, më datë 03.11.2022,

Shpall

SHPALLJE INTERNE Nr. -1/2022

*për plotësimin e vendeve të punës me avancim të nëpunësve gjyqësorë
në Gjykatën Themelore Strugë*

Gjykata Themelore Strugë ka nevojë për plotësimin e vendeve të punës, me çka shpall Shpallje interne për avancim të 5 (pesë) nëpunësve gjyqësorë, për vendet e punës si në vijim:

**1. Kategorija V, niveli V3, titulli: Bashkëpntor gjyqësor, vendi i punës:
Bashkëpntor gjyqësor, -2 (dy) – realizues – shifra SUD 0101V03001;**

Kushtet e veçanta:

- 300 kredi sipas EKTS ose të ketë të kryer shkallën VII/1 Fakulteti juridik dhe t'a ketë dhënë provimin e judikaturës,
- së paku 1 vjet përvojë pune në profesion, pas diplomimit,
- njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin European (anglisht, frangjisht ose gjermanisht),
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

**2. Kategorija G, niveli G1, Referent i pavarur gjyqësor, vendi i punës: -
Udhëheqës i shkresores – 3 (tre) realizues – shifra SUD 0101G01001;**

Kushtet e veçanta:

- të paktën shkollim i lartë apo shkollim i mesëm,
- të paktën 3 vite përvojë pune në profesion,

-njohje aktive të njërës nga tre gjuhët më shpesh të përdorura në Unionin Europian (anglisht, frangjisht ose gjermanisht),

-njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Shuma neto në të holla e mbledhjes nga pjesa e rrogës për shkallën e arsimit dhe pjesa e rrogës për nivelin është: për vendin e punës nën numrin 1 është 27.053,00 denarë; për vendin e punës nën numrin 2 është 19.174,00 denarë; Kohëzgjatja javore: 40 orë; Kohëzgjatja ditore e punës është 8 orë prej orës 07:30 deri në ora 15:30; Ditë pune: nga e hëna në të premte, kohëzgjatja e marëdhënies së punës është në kohë të pacaktuar.

Në shpalljen interne mund të paraqitet nëpunës gjyqësor i punësuar në Gjykatën Themelore Strugë, i cili i plotëson kushtet e veçanta për plotësim të vendit të punës të parapara për nivelin përkatës me Ligjin për Nëpunësa Gjyqësor dhe me Rregulloren për sistematizim dhe organizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatën Themelore Strugë, si dhe kushteve të përcaktuara konform nenin 39 paragrafi 5 nga Ligji për Nëpunësa Gjyqësor, edhe atë:

-të jetë notuar me notë “veçanërisht dallohet” apo “dallohet” gjatë notimit të fundit,

-të jetë në vendin e punës drejtpërdrejtë në nivel më të ulët ose të jetë në vendin e punës në kornizë të kategorisë së njëjtë në të cilin është vendi i punës për të cilin është shpallur shpallja interne,

-të ketë kaluar së paku dy vjet në vendin e punës në të cilin është caktuar,

-të mos jetë shqiptuar masë disiplinore në vitin e fundit para publikimit të shpalljes interne.

Kandidatët janë të detyruar të parashtojnë fletëparaqitje për avancim dhe dëshmi për plotësimin e kushteve të veçanta për vendin e punës, si dhe kushteve të caktuara konform nenit 39 paragrafi 5 nga Ligji për Nëpunësa Gjyqësor, në original apo kopje të vërtetuara në Noter.

Me fletëparaqitjen kandidatët mund t'i paraqesin në formë të skenuar edhe dëshmitë si në vijim:

-vërtetime për trajnime të realizuara në mënyrë të suksesshme si vizitor/trajnuar, jo më të vjetra se 5 vjetë, dhe/ose

-vërtetime për realizim të suksesshëm të mentorit, si mentor/nën mentorim.

Në fletëparaqitjen, përkrah dëshmimeve, detyrimisht duhet të përmbahet: emri dhe mbiemri i kandidatit, vendi aktual i punës, niveli, titulli dhe përvoja e punës e kandidatit, si dhe të dhënat në lidhje me nenin 39 paragrafi(5) nga Ligji për Nëpunësa Gjyqësor.

Afati për paraqitje është 6 (gjashtë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes interne në veb faqen e gjykatës.

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e paraqitjes.

Në fletëparaqitjen kandidatët janë të detyruar që me përgjegjësi materijale dhe penale të përdëftojnë që të dhënat në fletëparaqitjen janë të sakta, ndërsa provat e dërguara janë autentike me origjinalin. Kandidati i cili ka futur të dhëna të rrejshme në fletëparaqitje apo vërtetohet që ka futur të dhëna të rrejshme, diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët janë të detyruar që t'a dorëzojnë nëpërmjet shkresores për pranim të Gjykatës Themelore Strugë, deri tek

Komisioni për selektim për avancim, e njëjta mund të gjendet në mënyrë elektronike në internet faqen www.osstruga.mk apo të tërhiqet personalisht në hapsirat e Gjykatës.

Koha dhe data e mbajtjes së seleksionimit administrativ dhe intervistës do të shpallen në internet faqen e mësipërme të Gjykatës.

Kryetar i Gjykatës,
Ifet Bajramoski

